



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më

____.____.2023

VENDIM

Nr. 592, datë 18.10.2023

**PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR
PERIUdhËN 2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*”–“*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, gjyqtarja referuar objektit të mosmarrëveshjes dhe natyrës së çështjes (civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale në fazën e hetimit paraprak) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analitik të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor,

kompetencën lëndore dhe tokësore, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) ecuria procedurale e gjykimit në rastet kur është ndryshuar përbërja e trupit gjykues,¹ (ii) ecuria e veprimeve procedurale të kryera lidhur me lëshimin e deklaratës së mbrojtjes, aktet e njoftimit, afatin për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes gjykimit,² (iii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin e ndërgjyqësisë, thirrjen në gjykim edhe të personave të tjetër të paditur;³ (iv) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesat e palëve për ndryshimin e objektit të padisë;⁴ (v) zhvillimin e gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, (vi) legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve në raport me shkakun ligjor dhe objektin e padisë,⁵ etj. Në një nga çështjet civile objekt shqyrtimi, referuar natyrës së vendimit, gjyqtarja është ndaluar vetëm në pasqyrimin dhe analizën e fakteve me natyrë procedurale, që lidhen me përmbajtjen e kërkesëpadisë, e cila duke mos u paraqitur në formën e duhur procedurale, përcaktuar kjo nga natyra e vendimit gjyqësor, i cili është vendim për kthimin e padisë me të meta.⁶

Në vendimet penale burim vlerësimi, rrethanat që lidhen me ecurinë procedurale të gjykimit analizohen në pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, duke i kushtuar rëndësi përveç vlerësimit të gjykatës lidhur me elementët proceduralë që lidhen me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore përbërjen e trupit gjykues (*elementë të cilët analizohen në çdo vendim*), aspektet procedurale të caktimit të seancës, njoftimit dhe pjesëmarrjes së palëve në seancë, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, si dhe të drejtave procedurale të tyre, për të vijuar me pas, sipas rastit, me ecurinë procedurale të çështjes lidhur me (i) thirrjen dhe pjesëmarrjen në gjykim të Avokaturës së Shtetit;⁷ (ii) paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar,⁸ etj.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve të themelit (*penale, civile ose familjare*) përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë, si: procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar apo i zakonshëm në çështjet penale*), zhvillimi i gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, faza në të cilën ka vijuar gjyqtari në rastet e ndryshimit të trupit gjykues, etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron dhe analizon në mënyrë të detajuar faktet thelbësore të çështjes, duke i paraqitur ato në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe duke integruar në përmbajtje të

¹Vendimi nr.301, datë 01.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²Vendimi nr. 645, datë 17.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³Vendimi nr.135, datë 14.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁴Vendimi nr.944, datë 22.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁵Shih vendimin nr. 64, datë 28.01.2019, ku në pjesën e parë të arsyetimit, pas paraqitjes dhe vlerësimit lidhur me aspekte procedurale që lidhen me paraqitjen e padisë, juridiksionit dhe kompetencës së gjykatës për shqyrtimin e çështjes, gjyqtarja ka referuar dhe analizuar edhe legjitimitetin e palëve në gjykim.

⁶Vendim nr.879, datë 02.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁷Vendimi nr.314, datë 18.09.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁸Vendimi nr.215, datë 25.06.2019 dhe nr.518, datë 22.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën, mbi të cilat gjyqtarja ka konkluduar lidhur me faktet konkrete. Pra, në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me paraqitjen dhe analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të gjyqtarës lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes.

- Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja përcakton natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale (*gjykim themel, hetim paraprak apo seancë paraprake*). Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtarja përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje pronësie, shpërblimit të dëmit nga zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar të kontratës së punës, njohje e vërtetësisë së dokumentit etj.*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën procedohet në çështjet penale, apo seancën paraprake nëse jemi para një kërkesë dërgim në gjyq apo kërkesë për pushimin e procedimit penal.

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj. Në pjesën e parë përshkruese-arsyetuese gjyqtarja analizon juridiksionin dhe kompetencën e saj (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes. Në një rast,⁹ në funksion të konstatimit kryesisht të kompetencës në aspektin lëndor, gjyqtarja ka referuar në vendimet e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2016-3310, datë 19.12.2016, nr.264, datë 16.11.2016 dhe nr,00-2017-367, datë 07.04.2017. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes është evidentuar pothuajse në të gjitha çështjet e trajtuara, por edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi gjyqtarja ka identifikuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, si dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural:

⁹Vendim nr.423, datë 08.05.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

Në çështjet civile gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 5 dhe 16 të K.Pr.Civile, lidhur me objektin e mosmarrëveshjes dhe detyrimin e gjykatës për të bërë një cilësim të ndryshëm të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët;¹⁰ nenin 181/2 të K.Pr.Civile lidhur me vlerësimin për fazën e gjykimit, në rastet e ndryshimit të trupit gjykues;¹¹
- nenet 36/1, 32/a, 32/b, 36, 41, 43, 45/1, 46, 47, 59, 64, 510/d, 511/ç të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre (*çështje me objekt marrëdhënie pune, padi pronësie, pjesëtim pasurie, fitim i pronësisë me parashkrim fitues, njohje pronar, pavërtetësi dokumenti, ndryshim vendimi të AKKP, urdhër ekzekutimit etj.*).¹² Në disa çështje gjyqtarja ka referuar edhe në ligje të posaçme që përcaktojnë çështje të kompetencës lëndore dhe tokësore, duke referuar përkatësisht nenet 30/1, 44 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2019 “Për gjendjen civile”,¹³ nenin 7/ç të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;¹⁴ nenet 29 dhe 38 të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”,¹⁵
- nenet 71, 72 dhe 73 të K.Pr.Civile lidhur me përbërjen e trupit gjykues, nenet 106 dhe 107 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e detyrimit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore;¹⁶
- nenet 32/b dhe 32/c të K.Pr.Civile për të vlerësuar legjitimitetin në ngritjen e padisë së njohjes për vërtetësinë ose pavërtetësinë e dokumentit; nenin 233 të K.Pr.Civile lidhur me rastet e lejimit të provës me dëshmitarë;¹⁷
- nenin 154/a të K.Pr.Civile në lidhje me konstatimin e të metave të kërkesëpadsisë;¹⁸
- nenin 199/1 të K.Pr.Civile për kalimin procedural të personit juridik të cilit i kanë kaluar të drejtat e detyrimit e personit juridik që ka mbaruar; nenet 5 dhe 185 të K.Pr.Civile në lidhje me vendimmarrjen mbi kërkesën për ndryshimin e objektit të padisë; nenin 193 të K.Pr.Civile lidhur me thirrjen e personit të tretë;¹⁹
- nenet 154/a, 156 dhe 158/1 të K.Pr.Civile në lidhje me njoftimin e padisë palës së paditur me qëllim paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes, nenin 158 të K.Pr.Civile në lidhje me veprimet paraprake, nenin 158/b dhe 161 të K.Pr.Civile në lidhje me rregullimin e

¹⁰Vendimet nr.260, datë 26.03.2018, nr. 944, datë 22.11.2018, nr.17, datë 18.01.2017, nr.169, datë 27.02.2017, nr. 301, datë 01.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

¹¹Vendimi nr. 301, datë 01.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

¹²Dispozitat procedurale lidhur me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore referohen në çdo vendim civil burim vlerësimi

¹³Vendimi nr.830, datë 18.09.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

¹⁴Vendimet nr.301, datë 01.04.2019, nr.169, datë 27.02.2017 dhe nr.135, datë 14.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

¹⁵Vendimi nr.423, datë 18.05.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

¹⁶Në të gjitha vendimet civile burim vlerësimi

¹⁷Vendimi nr.64, datë 28.01.2019, nr.830, datë 18.09.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

¹⁸Vendimi nr.879, datë 02.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

¹⁹Vendimi nr.260, datë 26.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

ndërgjyqësisë;²⁰ nenin 79/a të K.Pr.Civile lidhur me njoftimin e akteve Avokaturës së Shtetit, me qëllim marrjen pjesë në gjykim;²¹

- nenet 510/d dhe 511 të K.Pr.Civile në lidhje me urdhrin e ekzekutimit dhe evidentimin e kushteve që duhet të rezultojnë për të cilësuar kontratën e huasë si titull ekzekutiv, si dhe për të përcaktuar natyrën e vërtet të aktit, pa u lidhur në emërtimin që kanë vendosur palët, referohet në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me kuptimin ligjor të “kredisë”;²²
- nenet 175 dhe 179 të K.Pr.Civile në lidhje me gjykimin në mungesë të të paditurit; nenet 224/a dhe 227 të K.Pr.Civile në lidhje me caktimin e ekspertit dhe detyrave përkatëse; nenin 323 të K.Pr.Civile në lidhje me zbatueshmërinë e dispozitave të pjesës së përgjithshme të K.Pr.Civile edhe për gjykimet e posaçme në mungesë të rregullimeve specifike; nenet 370 e vijues të K.Pr.Civile në lidhje me gjykimin për pjesëtimin e pasurive të paluajtshme,²³ etj.

Në çështjet familjare (me objekt zgjidhje martesë dhe lëshim i urdhrin të mbrojtjes) gjyqtarja identifikon ligjin e zbatueshëm procedural, duke referuar dispozitat si vijon:

- nenet 25, 36/1, 42, 41, 51, 54 dhe 158/b të K.Pr.Civile, në lidhje me përcaktimin e kompetencës dhe juridiksionit gjyqësor për shqyrtimin e çështjes, ecurinë procedurale të çështjes, zhvillimin e veprimeve paraprake dhe seancës së pajtimit;²⁴
- nenet 12, pika 1, 18 pika 1, 13/3, 19/2 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, lidhur me aspektet procedurale të shqyrtimit të çështjes për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, legjitimitetin e palëve, kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e çështjes, afatin e caktimit të seancës së verifikimit, etj.²⁵

Në çështjet penale, referuar natyrës së çështjes (*seancës paraprake, gjykim themeli apo kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake*), apo rritit të gjykimin (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 13/3, 15-18, 69/1, 74, 76 të K.Pr.Penale në drejtim të formimit, përbërjes së trupit gjykues, pajtueshmërisë së trupit gjykues, vlerësimit të çështjeve të juridiksionit, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, në gjykimet penale të themelit;²⁶
- nenet 403 dhe 405 të K.Pr.Penale në lidhje me institutin e gjykimin të shkurtuar, kushtet procedurale dhe thelbësore të aplikimit të tij; nenin 354 të K.Pr.Penale lidhur me fazën procedurale të parashtrimit të kërkesave paraprake; nenet 128, 129, 130 të K.Pr.Penale vlerësimin lidhur me pavlefshmërinë e akteve; nenin 151 të K.Pr.Penale lidhur me marrjen e provave gjatë hetimit paraprak dhe papërdorshmërinë e tyre;²⁷

²⁰Kjo dispozite identifikohet edhe në vendimin nr.135, datë 14.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²¹Vendimi nr.645 datë 17.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²²Vendimi nr.109, datë 26.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²³Vendimi nr. 130, datë 16.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²⁴Vendimet nr.15, datë 18.01.2017, nr.511, datë 11.06.2018 dhe nr.909, datë 24.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²⁵Vendimi nr. 92 akti, datë 02.08.2019 për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe vendimi nr.108, datë 23.09.2019 për verifikimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes

²⁶Vendimet nr.273, datë 10.09.2019, nr.518, datë 22.12.2017 dhe nr.215, datë 25.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²⁷Vendimet nr.518, datë 22.12.2017 dhe nr.215, datë 20.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

- nenin 79/1, shkronja "a" të K.Pr.Penale në lidhje me një nga rastet e bashkimit të procedimeve dhe konkretisht rasti kur vepra penale për të cilën zhvillohet procedimi është kryer nga disa persona në bashkëpunim ndërmjet tyre ose kur disa persona në mënyrë të pavarur kanë shkaktuar veprën; nenin 92/1, shkronja "a" të K.Pr.Penale lidhur me parakushtet procedurale për bashkimin e çështjeve; nenin 378/a të K.Pr.Penale lidhur me kërkesën për riçelje të hetimit gjyqësor;²⁸
 - nenin 393 të K.Pr.Penale, lidhur me shpenzimet gjyqësore në procesin penal, nenin 190 të K.Pr.Penale në lidhje me disponimin për provat materiale;²⁹
 - nenin 388 të K.Pr.Penale lidhur me vendimin e pafajësisë,³⁰
 - nenin 34/a të K.Pr.Penale lidhur me letrën e të drejtave; nenet 406/d, 406/dh, 406/e dhe 406/f të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me gjykimin me marrëveshje, kushtet e formës dhe përmbajtjes së marrëveshjes, shqyrtimin e saj nga gjykata miratimi i marrëveshjes;³¹
 - nenet 69/1, 74, 76, 13/2, 15-18, 331-332/gj të K.Pr.Penale, lidhur me juridiksionin, kompetencën funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake në shqyrtimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq; nenin 34/a të K.Pr.Penale, lidhur me të drejtat e të pandehurit në seancë paraprake dhe nenet 332/c, 332/d, 332/dh, 332/ë, 332/f të K.Pr.Penale, lidhur me shqyrtimin dhe vlerësimin e gjykatës në seancë paraprake, disponimin me vendim për dërgimin e çështjes në gjyq, formimin e fashikullit të gjyqimit dhe depozitimin e dosjes për t'iu nënshtruar procedurave të shortit;³²
 - nenet 328/1 dhe 329/a të K.Pr.Penale, lidhur me aspektet procedurale të shqyrtimit të kërkesës për pushimin e procedimit penal dhe rastet e pushimit të procedimit.³³
- *Sa i përket ligjit material të zbatueshëm*

Referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon dispozitat materiale të cilat gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori: (i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

Në vendimet civile, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Punës dhe Kodit të Familjes, ashtu edhe ligjeve të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, lidhur me:

- *Shpërblimin e dëmit që buron nga zgjidhja e marrëdhënies së punës*, ku gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenin 5 të Kodit të Punës, duke evidentuar se marrëdhëniet e punës të krijuara ndërmjet paditësit dhe të paditurit rregullohen nga dispozitat e ligjit të posaçëm nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" në fuqi në kohën e krijimit të marrëdhënies juridike mes palëve, neni 101 i tij, i cili përcakton

²⁸Vendimi nr.215, datë 25.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²⁹Vendimi nr.215, datë 25.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁰Vendimi nr.518, datë 22.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³¹Vendimi nr.83, datë 20.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³²Vendimet nr.553, datë 20.12.2018, nr.150, datë 02.05.2019 dhe nr.314, datë 18.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³³Vendimi nr.34, datë 29.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

kompetencat e drejtorisë dhe vendimmarrjet përkatëse, duke parashikuar rol ekzekutiv të këtij organi, duke përjashtuar këtë marrëdhënie pune/shërbimi nga fusha e veprimtarisë Kodi i Punës; nenin 120 të K. Punës në lidhje me interesat në rast vonese, nenin 6, 98, 99 të ligjit 7638/1992 në lidhje me personalitetin juridik, emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të drejtorisë dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre; nenet 10 dhe 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” në lidhje me përgjegjësinë e themeluesve, emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të sh.p.k.; nenin 158 të tij në lidhje me administratorët në sh.a., nenin 233 në lidhje me hyrjen në fuqi të ligjit, nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 8901, datë 23.05.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar në lidhje me procedurën e falimentimit, si dhe VKM nr. 336, datë 04.05.2016 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të tregjeve të tregtimit me shumicë dhe pakicë të fruta perimeve te njësitë e vetëqeverisjes vendore”.³⁴

- *Lidhur me padinë nëpërmjet të cilës kërkohet kundërshtimi i vendimit të ish KKP dhe detyrimin për njohje pronar, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, përkatësisht nenin 2 dhe 3 në lidhje me subjektet e shpronësuar, nenin 6 në lidhje me njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e pronës, nenin 15 në lidhje me organizimin dhe funksionimin e AKKP.; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, si dhe VKM nr. 255, datë 13.04.2010 “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuar gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompensimit të pronave” ;³⁵*
- *Fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, ky gjyqtarja identifikon nenet 169-170 të Kodit Civil, lidhur me mënyrën origjinale të fitimit të pronësisë me parashkrim fitues pa titull; nenet 193, 196 dhe 198 të K. Civil, si dhe ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” në lidhje me regjistrimin e vendimit të gjykatës; ligjin 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 244, datë 06.03.2009.³⁶*
- *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj, gjyqtarja identifikon dhe citon dispozitat ligjore familjare (nenet 1, 3, 5, 6, 50, 123, 125, 129, 132, 133, 145, 146, 192, 215, 216, 220 të Kodit të Familjes) në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj në lidhje me bashkëshortët dhe fëmijët e mitur;³⁷*
- *Në kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, krahas nenit 510 të K.Pr.Civile, i cili referohet për të përcaktuar cilësinë e kontratës së dhënies së kredisë si titull, referohen edhe nenin 450 i K.Civil, në lidhje me kamatat ligjore; nenet 1, 2, 3, 5 të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare” në lidhje me qëllimin e ligjit, fushën e zbatimit të tij, kuptimin e veprimit juridik tregtar dhe llogaritjen e kamatëvonesës. Po kështu, referohet neni 4, pika 1/6 dhe pika 31 i ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me kuptimin e termave “kredi” dhe “subjekt financiar jobankë”.³⁸*

³⁴Vendimi nr.301, datë 01.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁵Vendimi nr.944, datë 22.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁶Vendimi nr.645, datë 17.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁷Vendimet nr.909, datë 24.10.2017 dhe nr.15, datë 18.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁸Vendimi nr. 109, datë 26.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Punës, Kodit të Familjes dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, duke identifikuar konkretisht:

- nenin 53 të Kushtetutës, nenet 8 dhe 12 të KEDNJ, në çështjet me objekt zgjidhje martese, në lidhje me të drejtën për jetë private dhe familjare;³⁹
- dispozita të Konventës dhe Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës⁴⁰ lidhur me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.⁴¹

Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal në funksion të analizës së instituteve dhe parimeve të zbatueshme, si më poshtë:

- identifikon në funksion të vlerësimit lidhur me cilësimin juridik të faktit penal objekt akuze: nenin 190 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Falsifikim i vulave, stampave dhe formularëve”;⁴² nenin 291 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”;⁴³ nenin 199/a të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”;⁴⁴ nenin 283/1 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”;⁴⁵
- nenet 181, 199/a dhe 124 të Kodit Penal në lidhje e veprat penale “Mospagim i taksave dhe tatimeve”, “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Braktisja e fëmijëve të mitur”, për të cilat akuzohen të pandehurit dhe argumenteve të gjyqtarës lidhur me kualifikimin ligjor të faktit, në çështje për të cilat kërkohet dërgimi i çështjes në gjyq⁴⁶ apo pushimi i procedimit penal;⁴⁷
- në çdo rast, referohen dispozita pjesës së përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me: analizën e elementëve të anës subjektive të veprës penale (neni 14 i Kodit Penal); moshën për përgjegjësi penale dhe rrethanat e përjashtimit nga përgjegjësia (nenet 12 dhe 17 të Kodit Penal); parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (nenet 1/c dhe 47 të K. Penal); dispozitat lidhur me dënimet alternative (neni 59 dhe 63 i Kodit Penal) dhe institutin e bashkëpunimit dhe analizën e tij si rrethanë cilësuese e veprës penale,⁴⁸ etj.

Krahas dispozitave të Kodit Penal si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, si dhe një sërë ligjesh të posaçme në drejtim të vlerësimit të anës objektive të veprave penale specifike, dhe konkretisht:

³⁹Vendimi nr.511, datë 11.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Gjithashtu këto dispozita identifikohen edhe në vendimet nr. 909, datë 24.10.2017 dhe nr. 15, datë 18.01.2017

⁴⁰Miratur nga Asambleja e Përgjithshme e OKB në nëntor 1989

⁴¹Vendimet nr. 909, datë 24.10.2017 dhe nr. 15, datë 18.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁴²Vendimi nr.518, datë 22.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁴³Vendimi nr.273, datë 10.09.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁴⁴Vendimet nr.333, datë 10.10.2017 dhe nr.83, datë 20.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁴⁵Vendimi nr.215, datë 25.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁴⁶Vendimet nr.553, datë 20.12.2018, nr.150, datë 02.05.2019, nr.314, datë 18.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁴⁷Vendimi nr.34, datë 29.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁴⁸Vendimi nr.215, datë 25.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

- nenin 32 të Kushtetutës dhe KEDNJ lidhur me parimin se askush nuk mund të dënohet mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme;⁴⁹
- nenin 74 të ligjit nr. 8387, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” në kuadër të analizës së objektit të veprës penale “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190/3 i K.Penal;⁵⁰
- ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe prikotrope”, në funksion të analizës së anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal;⁵¹
- ligjin nr. 8387, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe nenin VKM nr.153, datë 07.04.2000 “Mbi miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, neni 346, në funksion të analizës së elementëve të objektit dhe anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 291 të K.Penal”;⁵²
- ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshkur, në kuadër të analizës së anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.⁵³

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në një rast konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet ndonjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsytimit lidhur me zgjidhjen e çështjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, spikat aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes

⁴⁹Vendimet nr.518, datë 22.12.2017 dhe nr.215, datë 25.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁵⁰Vendimi nr.518, datë 22.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁵¹Vendimi nr.215, datë 25.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁵²Vendimi nr.273, datë 10.09.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁵³Vendimi nr.333, datë 10.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore referohen ose citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarës është se citimi ose referimi i dispozitave, kryesisht atyre që aplikohen drejtpërdrejt për zgjidhjen në themel të çështjes, është shoqëruar me interpretimit të tyre në mënyrë të individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin *teleologjik* të normës konkrete duke identifikuar qëllimin e saj, por edhe interpretimin *literal* dhe *sistematik* të normave, duke përqasur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet civile përgjithësisht interpretimi i normës bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, duke e analizuar më pas normën në përputhje me faktin që ka rezultuar i provuar në gjykim. Në mënyrë më specifike, nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja :

- interpreton dispozitat materiale që rregullojnë institutin juridiko-civil të “*fitimit të pronësisë me parashkrim*” (*nenet 169/170 të K. Civil*) si një mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë, duke analizuar kushtet dhe kriteret ligjore të aplikimit të tij, sendi të jetë i aftë për t’u fituar me parashkrim, të mos jetë pronë publike e patjetërsueshme; posedimi i qetë dhe i pandërprerë duhet të vazhdojë për 20 vjet dhe sendi të jetë poseduar qetësisht, duke u sjellë si pronar dhe në mënyrë të pandërprerë. Po ashtu në kuadër të kësaj analize gjyqtarja interpreton dispozita të ligjit të posaçëm nr. 8742, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, duke u ndalur në analizën e koncepteve të pronës publike apo shtetërore, në kuadër të vlerësimit për aplikimin e institutit të parashkrimit fitues pa titull si mënyrë e fitimit të pronësisë;⁵⁴
- interpreton në mënyrë sistematike dispozitën kushtetuese (*nenin 53*) me nenet 8, 10 dhe 12 të KEDNJ, si dhe me nenin 50 të K.Familjes, në funksion të analizimit të institutit të martesës. Në këtë kontekst, gjyqtarja referon në *parimin e autonomisë së vullnetit të palëve në lidhjen e martesës*. Interpreton dispozitat materiale, konkretisht nenet 125, 129 dhe 132 të K.Familjes, lidhur me mbarimin e martesës nëpërmjet një prej formave të saj (*konkretisht zgjidhjes së saj*), duke u ndalur në mënyrë të veçantë te neni 132 i K.Familjes, i cili ka sanksionuar shkaqet e zgjidhjes së martesës. Gjithashtu, gjyqtarja interpreton dhe zbaton sanksionimin e parashikuar në nenin 146/1 të K.Familjes në lidhje me ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortit tjetër si një ndër pasojat *ipso lege* të zgjidhjes së martesës. Në vijim, në lidhje me zgjidhjen e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e martesës, gjykata

⁵⁴Vendimi nr.645, datë 17.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

përsa i përket mënyrës së ushtrimit të përgjegjesisë prindërore (*lënies së fëmijëve të mitur për rritje*) interpreton dispozitat materiale që kanë lidhje me të dhe më konkretisht nenet 2, 12, 6, 155 dhe 158 të K.Familjes. Në këtë kontekst, gjykata mban në konsideratë *parimin e interesit më të lartë të fëmijës*, duke analizuar gjerësisht elementët përbërës të këtij parimi, nën interpretimin e nenit 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve dhe nenit 12 të K.Familjes. Gjithashtu, në vijim të analizimit të pasojave juridike të fëmijët në rastin e zgjidhjes së martesës, gjyqtarja interpreton nenet 161, 192 dhe 197, të K.Familjes, lidhur me detyrimin për ushqim në përputhje me faktin dhe rrethanat e çështjes, konkretisht në proporcion me nevojat e fëmijës së mitur dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet (prindit);⁵⁵

- trajton marrëdhënien juridike kontraktuale të krijuar ndërmjet shoqërisë tregtare dhe administratorit të saj, duke analizuar në mënyrë të detajuar se ajo është e një natyre të veçantë, se nuk rregullohet prej Kodit të Punës, por sipas dispozitave të legjislacionit për shoqëritë tregtare;⁵⁶
- nëpërmjet interpretimit të dispozitave të Kodit të Punës, gjyqtarja analizon marrëdhënien juridike të punës, kohëzgjatjen e saj, formën e kontratës, përmbajtjen e saj, në funksion të përcaktimit të dispozitave që gjejnë zbatim në rastin e zgjidhjes apo përfundimit të saj. Pas kësaj analizë, gjyqtarja ndalet në interpretimin e neneve 141, 143, 144, 153 të Kodit të Punës, duke analizuar çështje të afatit, procedurës dhe shkaqeve të arsyeshme apo të justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, institutin e mirëbesimit në marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës, për të konkluduar se marrëdhënia e punës është zgjidhur pa shkaqe të justifikuara. Më pas gjyqtarja ndalet në interpretimin e nenit 155 të Kodit të Punës, në drejtim të përcaktimit të pasojave të zgjidhjes së marrëdhënies së punës, në rastet kur ajo është vlerësuar si e menjëhershme dhe e pajustificuar, si dhe në analizën e kritereve që do të konsiderohen në përcaktimin e masës së dëmshpërblimit;⁵⁷
- interpreton nenin 510 shkronja “d” të K.Pr.Civile dhe nenin 4 të ligjit nr. 9662 datë 18.12.2006, “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” duke qenë se kanë lidhje me njëra-tjetrën. Në bazë të këtij interpretimi dhe në përputhje me faktin objekt gjykimi, gjyqtarja konkudon dhe identifikon se kontrata objekt gjykimi është një kontratë bankare, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, e si e tillë, përbën titull ekzekutiv, në kuptim të nenit 510 shkronja “d” të K.Pr.Civile.⁵⁸

Në vendimet penale gjyqtarja interpreton dispozitat materiale (*nenet 283/1, 324/a, 199/a, 291 dhe 181 të Kodit Penal*) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkohet dërgimi në gjyq apo gjykimi i të pandehurit dhe të përcaktimit të përgjegjesisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal dhe duke analizuar elementët e figurës së veprës penale për të

⁵⁵Vendim nr.902, datë 07.09.2015 dhe nr.415, datë 15.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁵⁶Vendimi nr.301, datë 01.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁵⁷Vendimi nr.169, datë 27.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁵⁸Vendimi nr.109, datë 26.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

cilën procedohet, dhe sipas rastit elementët cilësues të saj. Gjyqtarja interpreton në nivel teorik normën relevante të K.Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, e në vijim, duke e përqsaur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.⁵⁹

Përgjithësisht, dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen duke zbrërthyer të katër elementët e figurës së veprës penale, por duke u përqendruar më tepër në anën objektive dhe subjektive të saj, duke u ndalur në elementë të tillë siç është forma e kryerës së veprës penale të parashikuar nga neni 283 i K. Penal dhe duke analizuar në këtë drejtime dhe formën e “mbajtjes” së lëndës narkotike, konceptin e “dozës së vogël”, dhe atë të “përdorimit vetjak”, në funksion të konkluzionit për provueshmërinë e anës objektive të kësaj veprë.⁶⁰ Në ato raste kur dispozita e pjesës së posaçme të K. Penal në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit është një dispozitë bankete ose kur është i nevojshëm referimi në ligje të posaçëm për të analizuar objektin dhe anën objektive të veprës penale, gjyqtarja zbaton dhe në disa raste referon në interpretim edhe në dispozita të ligjeve të posaçme ku të referon fakti penal.⁶¹

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast gjyqtarja interpreton *dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal*, në drejtim të elementëve dhe instituteve, si më poshtë:

- interpreton dispozitat që lidhen me përcaktimin e dënimit penal, duke u ndalur në qëllimin e dënimit penal, individualizimin e tij (*nenet 47, 48, 49, 50 të K. Penal*), kushtet dhe kriteret ligjore që merren në konsideratë në caktimin dhe individualizimin e dënimit (*objekti, vendi, koha, gjendja në të cilën është kryer vepra penale, rrethanat e kryerjes së saj, nëse është e përhapur në atë rreth ku është kryer*) dhe rrezikshmërinë e autorit (*gjendja sociale, profesioni, arsimimi, gjendja familjare, gjendja gjyqësore, shkalla e fajit*), ndikimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese (*nenet 48,49,50 të Kodit Penal*), etj.
- interpreton dispozitën materiale penale (*nenin 63 të K. Penal*), në lidhje me aplikimin e *alternativave të ekzekutimit të dënimit me burgim*, pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, duke u ndalur në kriteret ligjore që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative për të përfituar i pandehuri aplikimin e kësaj alternative të dënimit me burgim.⁶²

⁵⁹Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza teorike e dispozitave penale në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, para aplikimit mbi faktet e çështjes

⁶⁰Vendimi nr.215, datë 25.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶¹Vendimi nr. 215, datë 25.06.2019 në të cilin për interpretimin e nenit 283 të K.Penal, posaçërisht të elementëve të objektit dhe anës objektive të veprës i referohet ligjit nr. 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”; Vendimi nr.518, datë 22.12.2017 në të cilin, në kuadër të analizës së elementëve të objektit dhe anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 190/3 i Kodit Penal, referon dhe interpreton nenin 79 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 të “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, etj.

⁶²Vendimi nr.273, datë 10.09.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësi interpretimit të normës, si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake; në kërkesën penale për deklarim ikje, në çështjen në të cilat është vendosur kthimi i akteve, etj. Konkretisht:

- argumentimit të saj në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar (*neni 403, 406 i K.Pr.Penale*), në mbështetje të të cilit referon edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*); interpreton dispozitat procedurale penale dhe referon praktikën gjyqësore relevante në lidhje me parimet bazë të procedimit penal të tilla si parimi i prezumimit të pafajësisë;⁶³ si dhe parimin e ligjshmërisë së marrjes së provave dhe vlerësimin e tyre në kuadër të vlerësimit të tyre në marrjen e vendimit;⁶⁴
- në çështjen penale me objekt “Pushimin e procedimit penal”, gjyqtarja interpreton nenin 328 të K.Pr.Penale duke trajtuar rastet e pushimit të procedimit penal, para përjasjes së tyre mbi faktet konkrete të çështjes, në kuadër të vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesës objekt shqyrtimi;⁶⁵
- në çështjen me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi”, merr në analizë dispozitat procedurale civile, duke referuar edhe praktikën gjyqësore relevante, në drejtim të vlerësimit të kompetencës tokësore të gjykatës dhe analizon në këtë drejtim konceptin e “gjykata e vendit të ekzekutimi”, si elementet përcaktuar për kompetencën tokësore,⁶⁶ etj.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Lidhur me analizën e konceptit të “Gjykata e vendit të ekzekutimit”, gjyqtarja referon jurisprudencën jounifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 332, 13.07.2010 dhe nr.333, datë 13.07.2010 të Kolegjit Civil;⁶⁷
- Në rastet e trajtimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, gjyqtarja referon qëndrimin e Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003;
- Në funksion të analizës ligjore lidhur me institutin e bashkëpunimit dhe kushteve kumulative që duhet të ekzistojnë për të konkluduar për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, gjyqtarja identifikon dhe referon vendimin unifikues nr. 4, datë 15.04.2011;⁶⁸
- Referon jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht vendimin nr. 57, datë 21.12.2012 në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë;⁶⁹
- Referuar vendimit unifikues nr. 19/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës me afat të pacaktuar. Referon jurisprudencën

⁶³Vendimi nr. 518, datë 22.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶⁴Vendimi nr.215, datë 25.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶⁵Vendimi nr.34, datë 29.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶⁶Vendimi nr.109, datë 26.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶⁷ Vendimi nr.109, datë 26.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶⁸Vendimi nr. 215, datë 25.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶⁹Vendimi nr. 518, datë 22.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

jounifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 00-2014-958, datë 03.04.2014 në lidhje me kompetencën lëndore për mosmarrëveshjet që rrjedhin nga kontrata e punës;⁷⁰

- Referon jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimet nr. 357, datë 11.09.2008 dhe nr. 202, datë 24.04.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me interesin më të lartë të fëmijës dhe mënyrën e vlerësimit të tij,⁷¹ etj.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njih, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, *si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të humanizmit, përshtatshmërisë së llojit dhe masës së dënimit (neni 47, 1/b dhe 1/c i K. Penal)*, të cilat referohen dhe analizohen më pas në raport me rrethanat konkrete të çështjes.
- *Parimin e “gjësë së gjykuar”* dhe efektet e tij⁷² parimin e ligjshmërisë dhe ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtin fakt;⁷³
- *Parimin e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine legge*, i referuar dhe po ashtu i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në vendimet penale të themelit dhe ato të seancës paraprake.
- *Parimin e procesit të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ dhe neni 42 i Kushtetutës)* si dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke iu referuar aspektit procedural të gjykimit që lidhet me të drejtën e mbrojtjes; *Parimi i prezumimit të pafajësisë* i sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale.
- *Parimin e interesit më të lartë moral dhe material të fëmijëve të mitur*, duke cituar për këtë qëllim neni 2 të K.Familjes, dispozita të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”. Në kuadër të analizës lidhur me të drejtën për martesë, të drejtën për jetë private dhe familjare, gjyqtarja referon parimin e autonomisë së vullnetit të palëve në lidhjen e martesës.
- *Parimin “Judicis est judicare secundum allegata et probata”*, sipas së cilit vendimmarrja e një gjyqtari duhet të bëhet në bazë të bindjes së brendshme të bazuar në prova.⁷⁴
- *Parimin e veprimit të ligjit civil në kohë* në funksion të evidentimit të ligjit të zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprimit juridik.⁷⁵
- *Parimin e mirëbesimit* mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, në kuadër të analizës lidhur me shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës.⁷⁶

⁷⁰Vendimi nr.169, datë 27.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁷¹ Vendimet nr. 909, datë 24.10.2017 dhe nr. 15, datë 18.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁷²Vendimi nr. 130, datë 16.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁷³Vendimi nr. 423, datë 08.05.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁷⁴Vendimi nr. 17, datë 18.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁷⁵Vendimi nr. 301, datë 01.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁷⁶Vendimi nr. 169, datë 27.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdesi i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuar, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në kllapa ose thonjëza), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.⁷⁷ Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit apo në kuadër të referimit të ligjeve të posaçme, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare (*me objekt zgjidhje martesë*), evidentohet kujdesi i gjyqtarës për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të pretendimeve nga palët, në respektim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit.

⁷⁷P.sh: *in dubio pro reo; iudicis est iudicare secundum allegata et probata; res iudicata; ratione loci; ratione personae; ratione materiae; etj.*

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuar në nënndarje, të identifikuar në shumicën e vendimeve me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë në përmbyllje procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ndjek metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, trupi gjyqësor dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objekti i kërkesës në çështjet penale*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat kryesisht janë të listuar formalisht me tituj, duke orientuar qartë lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Mënyra e organizimit të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek kryesisht këtë renditje:

- (i) *procedura*, duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes, si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës, etj. Në këtë pjesë në vendimet penale të themelit evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar në çështjet penale të themelit, kërkesës për bashkimin e çështjeve, kërkesës për riçelje të hetimit gjyqësor, etj. Në vendimet civile rezultojnë që në pjesën hyrëse të jenë analizuar me vete elementët procedurale të lidhur me kompetencën, juridiksionin, përbërjen e gjykatës, kërkesën për ndryshimin e objektit të padisë, thirrjen e personit të tretë në gjykim, ezaurimin e procedurës së pajtimit në çështjet me objekt zgjidhje martesë.
- (ii) *Rrethanat e faktit së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave* të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuar në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave. Faktet e çështjes analizohen në pjesën e dytë ose të parë të vendimit, duke integruar dhe analizuar provat e marra dhe duke u ndalur edhe në vlerën provuese të tyre. Gjyqtarja i kushton rëndësi kësaj pjese të arsyetimit të vendimit, duke u paraqitur faktet e çështjes në mënyrë analitike por edhe koncize, duke i dhënë qartësi faktit penal apo civil objekt gjykimi. Në disa nga vendimet gjyqësore, pas analizës së fakteve të çështjes, evidentohen në një pjesë të veçantë edhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse,⁷⁸ ndërsa në rastet e tjera ato janë evidentuar në atë pjesë të arsyetimit të vendimit ku janë marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë e tyre.
- (iii) *Ligji i zbatueshëm*. Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai me natyrë procedurale ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij.
- (iv) *Analizën ose vlerësimin ligjor* të gjykatës lidhur me çështjen. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve, arsyetimi vijon me një nënndarje përgjithësisht të titulluar “analiza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës”, në të cilin, sipas kategorisë së vendimeve gjyqtarja zhvillon analizën ligjore të çështjes. Kjo analizë, referuar kompleksitetit të çështjes është e organizuar në shumicën e rasteve në nënndarje, ku merren në analizë secili nga kërkimet e objektit të padisë, apo analizën lidhur me përgjegjësinë penale për

⁷⁸Vendimet nr.169, datë 27.02.2017, nr.301, datë 01.04.2019, nr. 944, datë 22.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

secilin të pandehur apo vepër për të cilën procedohet, në vendimet penale. Konkretisht, *në vendimet penale të seancës paraprake- dërgim në gjyq*, gjyqtarja e ka organizuar arsyetimin sipas kategorisë së elementëve që merr në vlerësim (i) vlefshmërinë e akteve procedurale; (ii) vlerësimin mbi kërkesën për procedim me gjykim të shkurtuar (iii) përmbajtjen dhe formimin e fashikullit të gjykimit dhe (iv) cilësimi juridik të faktit penal. Në pjesën e fundit të arsyetimit të vendimit, evidenton përmbajtjen e fashikullit të gjykimit në rastin e pranimin të kërkesës, në kuptim të nenit 332/ë të K.Pr.Penale.⁷⁹ *Në vendimet penale të themelit* analiza ligjore organizohet duke filluar me referimin e ligjit material të zbatueshëm, zbrërthimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale konkrete dhe përjasjen e tyre me faktin penal të provuar në gjykim, për të vijuar me konkluzionin mbi ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit dhe më tej me analizën në një pjesë më vetë, lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit. *Në vendimet civile dhe familjare* burim vlerësimi, gjyqtarja e organizon pjesën e analizës ligjore duke marrë në vlerësim, në mënyrë të veçantë secilin kërkim objekt padie, apo secilin elementët që ajo vlerëson të nevojshme për t'iu nënshtruar analizës ligjore. Pjesë e analizës ligjore, në përmbajtje apo në përfundim të argumentimit të saj lidhur me zgjidhjen e çështjes, janë edhe pretendimet e palëve të cilat merren në analizë me vete. Në tërësi, gjyqtarja organizon pjesën e arsyetimit ligjor të vendimit duke ndjekur kryesisht metodën e dhënies së konkluzionit të saj mbi bazueshmërinë ose jo të kërtimeve objekt padie, për të vijuar më pas me shtjellimin dhe renditjen e argumenteve në mbështetje të këtij konkluzioni. Në përfundim të analizës ligjore në tërësi, ose në lidhje me secilën çështje të shtruar për vlerësim apo kërkesë të objektit të padisë, gjyqtarja konkludon lidhur me çështjen, duke e paraqitur këtë pjesë, si sintezë të analizës ligjore të kryer.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarës dhe sekretarës gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi: (i) çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), (ii) përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor apo të pafajshëm*), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (*dërgimin në gjyq apo pushimin e procedimit penal*), (iii) dënimin dhe masën e dënimit, (iv) llogaritjen e dënimit, (v) mënyrën e ekzekutimit të tij, (vi) disponimi mbi provat materiale; (vii) masat e sigurimit si dhe (viii) shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e

⁷⁹Vendimet nr.314, datë 18.09.2019, nr.150, datë 02.05.2019, nr. 553, datë 20.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale themelit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; përcaktimit të barrës së provës dhe rolin e gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë, rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake; procedimit me gjykim të shkurtuar, si dhe pjesëmarrjen dhe të drejtat e të dëmtuarit në gjykim, etj.

Arsyetimi i vendimeve burim vlerësimi ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore dhe koncize të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Pasi dispozita zërthehet dhe interpretohet në kuptimin abstrakt, ajo vijon të aplikohet mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të zgjidhjes së çështjes. Gjyqtarja tregon kujdes në arsyetim dhe mënyrën e organizimit të tij, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes/çështjes dhe zgjidhjen e saj në themel.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi gjyqtarja kujdeset për të evidentuar në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit/çështjes, duke orientuar analizën juridike dhe duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje

me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja i kushton rëndësi evidentimit dhe argumentimit ligjor në drejtim të marrëdhënies shkak-pasojë, në përjasjen e ligjit me faktet konkrete. Arsyetimi i vendimeve është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim nga gjyqtarja.

Në vendimet civile burim vlerësimi gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh:

- (i) institutit të zgjidhjes së martesës dhe përcaktimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar martesën, shkaqet e zgjidhjes së saj, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke u ndalur në këtë drejtim në pasojat në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe ato me karakter material, analizë e cila mbështetet në çdo rast në parimin e interesit më të lartë të fëmijës;⁸⁰
- (ii) analizën e padisë së njohjes sipas parashikimeve të nenit 32/c të K.Pr.Civile, duke u ndalur në mënyrë të posaçme në çështje të interesit të ligjshëm, legjitimitetin të palës paditëse për ngritjen e kësaj padie, dhe duke vijuar me analizën e rrethanave konkrete të kërkimit mbi vërtetësinë e të dhënave të pasqyruara në fletën e regjistrit të marrëdhënieve të punës;⁸¹
- (i) institutit juridik të dëmshpërblimit në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke analizuar në mënyrë të posaçme elementët e kontratës së punës, formën e saj, procedurën dhe afatet e zgjidhjes së kontratës, shkaqet e justifikuar, pasojat që vijnë nga mosrespektimi i dispozitave ligjore nga ana e punëdhënësit, duke referuar në funksion të analizës edhe në qëndrime të praktikës gjyqësore;⁸²
- (ii) koncepti i “*Subjektit të shpronësuar*” në kuptim të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*” i ndryshuar, si dhe kushtet e përfitimit dhe dokumentacioni sipas këtij ligji dhe VKM nr. 255, datë 13.04.2010. Nëse paditësit plotësojnë kushtet ligjore për t’u njohur e drejta e pronësisë mbi pronat e pretenduara në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*” i ndryshuar dhe VKM nr. 255, datë 13.04.2010;⁸³
- (iii) Fitimit të së drejtës së pronësisë nëpërmjet parashkrimit fitues pa titull, duke zbrëthyer dhe analizuar në mënyrë të detajuar kushtet e kumulative që duhet të përmbushen për të qenë para kësaj mënyre të fitimit të së drejtës së pronësisë,⁸⁴ etj.

Në vendimet penale burim vlerësimi karakteristikë e gjyqtarës është paraqitja dhe analiza e detajuar e fakteve të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet, rolin dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit në raport me faktin penal. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështetin, si dhe elementin që sjell

⁸⁰Vendimet nr. 909, datë 24.10.2017 dhe nr.15, datë 18.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁸¹Vendimi nr.64, datë 28.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁸²Vendimi nr.169, datë 27.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁸³Vendimi nr.944, datë 22.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁸⁴Vendimi nr.645, datë 17.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë së tij. Gjyqtarja integron në mënyrë të natyrshme faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve ligjore për zgjidhjen e çështjeve me karakter procedural.

Gjyqtarja ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit, faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake, apo në raport me faktin për të cilin kërkohet pushimi i procedimit penal. Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimit logjik, në mbështetje të konkluzioneve të saj për zgjidhjen e çështjes, kryesisht në drejtim të:

- (i) analizës së figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet, zberthimin dhe analizën e elementëve e saj, si dhe autorësisë e të pandehurit;
- (ii) institutit procedural të gjykimit të shkurtuar, duke analizuar në çdo rast kushtet procedural për pranimin e tij së bashku me analizën dhe vlerësimin mbi kushtet thelbësore që vlerësohen për procedimin me këtë rit të posaçëm gjykimi;
- (iii) analizës lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktimi dhe individualizimit të dënimit, analizës lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese që ndikojnë për përcaktimin e dënimit si dhe aplikimin në këtë drejtim të parimeve mbi të cilat caktohet dënimi penal në funksion të arritjes së qëllimit të tij. Po ashtu gjyqtarja zhvillon analizën e kushteve ligjore të aplikimit të alternativave të dënimit me burgim duke u ndalur në analizën e kriterëve ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për aplikimin e kësaj alternative.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.) Pretendimet e palëve merren gjithmonë në shqyrtim dhe analizohen në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke u dhënë një përgjigje të argumentuar dhe duke u analizuar në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre. Ato integrohen natyrshëm në arsyetimin tërësor të vendimit gjyqësor.

Në disa vendime gjyqësore argumenti rrjedh nga konkluzioni i gjyqtares i parashtruar në fillim të arsyetimit, pas analizës së provave, për të vijuar hap pas hapi me shtjellimin e argumenteve në mbështetje të tij. Ndërkohë në vendimet e tjera burim vlerësimi nuk është ndjekur kjo mënyrë arsyetimi, por analiza dhe arritja e konkluzionit vjen pas analizës së ligjore të çështjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “*Cilësia e analizës dhe argumentit logjik*”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek përgjithësisht

rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.a Respektimi i afateve ligjore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 439 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi (173 çështje⁸⁵ në vitin 2017, 126 çështje⁸⁶ në vitin 2018 dhe 140⁸⁷ çështje në vitin

⁸⁵Çështjet me afat ligjor, viti 2017: Tabela nr.1-numër rendor 4; Tabela nr.2- numër rendor 24, 41, 51-148; Tabela nr.3- numër rendor 41-63; Tabela nr.10- numër rendor 1-33, 37-41, 46 (këtu nuk është përfshirë çështja me nr. rendor 34, me objekt “Kundërshtim vendim mosfillim i procedimit penal, pasi afati ligjor 30 ditor për shqyrtimin e kësaj çështje është parashikuar për herë të parë me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr.35/2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.08.2017, dhe çështja rezulton të jetë regjistruar në datën 16.01.2017 dhe ka përfunduar 13.03.2017); Tabela nr.11- numër rendor 1, 2, 4-6, 8, 11-13 dhe Tabela nr.12- numër rendor 13.

2019), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, “Penale seancë parapake” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë” .

Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (87 çështje),⁸⁸ me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (438 çështje),⁸⁹ gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 19.8% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja parashtron se, në analizë të të dhënave statistikore rezulton se në vitin 2017 ka gjykuar 172 çështje me afat ligjor dhe 34 prej tyre kanë përfunduar jashtë afatit. Nga këto, numrin më të lartë e zënë kategoria e çështjeve pa palë kundërshtare, ku 29 nga 100 çështje me afat ligjor janë jashtë këtij afati. Për vitin 2018, nga 127 çështje me afat ligjor, rezulton të jenë gjykuar jashtë afatit 22 çështje. Gjithashtu gjyqtarja parashtron se në disa çështje tejkalimi i afatit ligjor ka qenë i papërfillshëm vetëm me 1 ose 2 ditë apo në disa çështje është llogaritur afati ligjor duke marrë në konsideratë edhe lejen vjetore dhe nëse do të zbritej ky afat çështjet do të rezultonin të gjykuara brenda afatit ligjor.⁹⁰

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat nga burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar

⁸⁶Çështjet me afat ligjor, viti 2018: Tabela nr.2- numër rendor 17, 22, 39; Tabela nr.3- numër rendor 42-53; Tabela nr.10- numër rendor 1-64; Tabela nr.11- numër rendor 1, 3-10, 13, 15, 17, 20, 21, 23, 24, 26, 29, 35-38, 40, 42, 44, 45, 47, 49, 50, 52, 53, 55-57, 59-62, 66, 67, 69-72, 75, 77, 78.

⁸⁷Çështjet me afat ligjor, vitin 2019: Tabela nr.1- numër rendor 2, 9, 37; Tabela nr.2-numër rendor 36, 40, 43, 54, 57; Tabela nr.3- numër rendor 74-94; Tabela nr.10- numër rendor 1-38, 40-44, 46, 47, 49-68; Tabela nr.11- numër rendor 1-6, 9, 10, 13, 15, 18, 21, 23-28, 30, 31, 35-37, 40-42, 46-50, 52-56, 60-62, 64, 65, 72, 74, 75, 77, 80

⁸⁸Çështjet të përfunduara jashtë afatit ligjor, viti 2017 janë: Tabela nr.2-numër rendor 24, 51, 56-65, 70-74, 78, 79, 86, 90, 98-102, 113, 120, 122, 129; Tabela nr.3- numër rendor 57, 58; Tabela nr.10- numër rendor 30, 37 dhe Tabela nr.12- numër rendor 13. Pa përfshirë këtu çështjen me numër rendor 10, tabela 11/2017 pasi çështja ka objekt “Kërkesë për pushim procedimi penal” dhe jo “Dërgim në gjyq” sikurse pasqyrohet në të dhënat statistikore

Çështjet të përfunduara jashtë afatit ligjor, viti 2018 janë: Tabela nr.2-numër rendor 22, 39; Tabela nr.10-numër rendor 4, 5, 27, 38, 43, 56, 59, 61, 63; Tabela nr.11-numër rendor 3, 4, 8, 10, 13, 23, 42, 52, 53, 55, 56, 67, 71, 75, 78.

Çështjet të përfunduara jashtë afatit ligjor, viti 2019 janë: Tabela nr.2- numër rendor 36; Tabela nr.3- numër rendor 81, 87, 90, 91, 92; Tabela nr.10- numër rendor 38, 53, 68; Tabela nr.11- numër rendor 9, 10, 13, 24, 31, 36, 37, 46, 47, 50, 55, 56, 60, 61, 62, 64, 65

⁸⁹Këtu nuk është përfshirë çështja me numër rendor 10, në Tabelën nr.11, viti 2017, pasi gjyqtarja në Formularin e vetëvlerësimit ka deklaruar se çështja ka objekt “Kërkesë për pushimin e procedimit penale” dhe jo “Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq” sikurse pasqyrohet në të dhënat statistikore

⁹⁰Gjyqtarja ka referuar shpjegimet si më sipër, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë projektraport, por që parashtrihen në mënyrë të detajuar në raportin analitik, faqe 31-33, duke u referuar edhe në çështje konkrete

tabelave me të dhënat statistikore, për 87 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se:

- për 23 (njëzet e tre) çështje⁹¹ me objekt “*Lëshim urdhër ekzekutimi*”, vendimi është marrë për një afat prej 6 apo 7 ditësh, duke tejkuluar afatin ligjor me 1 dhe 2 ditë. Tejkulim ky i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit;
- çështja me objekt “Revokim mase sigurimi”,⁹² është regjistruar në gjykatë në datën 18.04.2017 dhe i është caktuar gjyqtarës në datën 19.04.2017, nëse përlllogaritja e afatit të gjykimit do të fillonte nga data e caktimit të çështjes, atëherë kjo çështje do të kishte përfunduar për 5 ditë, pra brenda afatit ligjor 5 ditor të parashikuar nga nenin 260 i K.Pr.Penale. Për pasojë kjo çështje nuk përfshihet në çështjet e përfunduara jashtë afatit ligjor, duke qenë se kohëzgjatja e saj ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës;
- në çështjet me objekt “*caktim mase sigurimi*”, për të cilat neni 244 në lidhje me nenin 260 të K.Pr.Penale parashikon afatin 5 ditor për shqyrtimin e kërkesës, në raportin analitik rezulton se janë konstatuar tej afatit *çështja me nr. rendor 4, 5 dhe 27, tabela nr. 10, viti 2018*, duke konsideruar afatin ligjor të shqyrtimit 48 orë. Nëse do t’i referohemi afatit 5 ditor, duke konsideruar parashikimet e nenit 244 në lidhje me nenin 260 të K.Pr.Penale,⁹³ rezulton se këto kërkesa janë shqyrtuar për 3 dhe 5 ditë nga data e regjistrimit të tyre. Referuar afatit ligjor 5 ditor për shqyrtimin e kërkesës, rezulton se këto 3 (tre) çështje janë gjykuar brenda afatit ligjor dhe për pasojë duhet të zbriten nga numri i çështjeve të konsideruara si të përfunduara jashtë afatit ligjor;
- për 1 (një) çështje⁹⁴ me objekt “*Kundërshtim vendimi mosfillimit të procedimit penal*”, vendimi është marrë për një afat prej 33 ditësh nga momenti i regjistrimit apo 32 ditësh nga momenti i caktimit të çështjes me short, duke tejkuluar afatin ligjor me 3 apo 2 ditë. Tejkulim ky i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit;
- për 10 (dhjetë) çështje,⁹⁵ me objekt “*Dërgim në gjyq*”, për të cilat neni 332/3 i K.Pr.Penale parashikon afatin 30 ditor të gjykimit, rezulton se vendimi është marrë për një afat prej 31, 32, 33, 34, 35, 38 dhe 40 ditësh, duke tejkuluar afatin ligjor me 1, 2, 3, 4, 5, 8 dhe 10 ditë, ku në pesë çështjet e fundit në tejkulimin e afatit ligjor ka ndikuar edhe periudha e fund vitit e cila përkon me procesin e

p

⁹¹Në tabelën nr.2 të vitit 2017 çështjet me numër rendor 51, 56-58, 61-65, 70, 71, 73, 78, 79, 90, 98-102, 113, 120, 122

⁹²Në tabelën nr.10, të vitit 2017 çështja me numër rendor 37

⁹³Në nenin 244 të K.Pr.Penale nuk parashikohet afat për shqyrtimin e kërkesës për caktim mase sigurimi ndërsa në nenin 260, pika 4 të K.Pr.Penale parashikohet se: “4.Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj”.

⁹⁴Në tabelën nr.10 të vitit 2018 çështja me numër rendor 38

⁹⁵Në tabelën nr.11 të vitit 2018 çështjet me nr. rendor 23, 42, 71 dhe të vitit 2019 çështjet me nr. rendor 47, 56; Në tabelën nr.11 të vitit 2018 çështjet me nr. rendor 3, 4, 8, 10 dhe të vitit 2019 çështja me numër rendor 13

mbajtjeve të dosjeve nga administrata gjyqësore; Ndërsa për 4 (katër) çështje⁹⁶ të tjera, të regjistruara dhe të shortuara në muajin korrik, kanë përfunduar në muajin shtator apo tetor. Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha që gjyqtarja ka qenë me leje vjetore (*muaj gusht*), atëherë këto çështje do të kishte përfunduar për 13, 11, 19, 25 ditë, pra brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 332/3 të K.Pr.Penale;

- Po ashtu rezulton se në çështja me nr. rendor 13, tabela 11, viti 2019 me objekt “*Dërgimin e çështjes në gjyq*”, është regjistruar në datën 06.11.2018 dhe e është caktuar gjyqtarës me short në datën 26.12.2018. Nëse përlllogaritja e afatit të gjykimit do të fillonte nga data e caktimit të çështjes me short gjyqtarës, atëherë kjo çështje do të kishte përfunduar për 40 ditë. Pra, për këtë çështje, afati ligjor është tejkaluar me 10 ditë, por duke pasur në vëmendje këtu që çështja i është caktuar gjyqtarës në fund të vitit, periudhë kjo që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata, çështja do të konsiderohet se ka përfunduar brenda afatit ligjor;
- për 1 (një)⁹⁷ çështje me objekt “*Sigurim padie*”, nëse përlllogaritja e afatit të gjykimit do të fillonte nga data e caktimit të çështjes me short, atëherë këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit ligjor 5 ditor të parashikuar në nenin 202 i K.Pr.Civile. Për pasojë këto çështje nuk përfshihen në çështjet e përfunduara jashtë afatit ligjor, duke qenë se kohëzgjatja e tyre ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës.

Nga një rillogaritje matematikore e përqindjes së çështjeve të shqyrtuara tej afateve ligjore, duke zbritur nga totali prej 87 çështje, 44 çështjet e mësipërme të cilat duhet të konsiderohen në afat, pasi tejkalimi i afatit ka qenë i papërfillshëm ose objektivisht i pashmangshëm, rezulton se kjo përqindje është 9.8%.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, do të përjashtoheshin çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër, si dhe çështjet me objekt “*caktim mase sigurimi*”, duke përlllogaritur si afat ligjor atë 5-ditor, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 43 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (43 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (438 çështje), rezulton të jetë **9.8% të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor**.

⁹⁶Në tabelën nr.11 të vitit 2019 çështjet me nr. rendor 60, 61, 62, 64

⁹⁷Në tabelën nr.2 të vitit 2019 çështja me nr. rendor 36

Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 9.36%.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 943⁹⁸ çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (246 çështje në vitin 2017, 293 çështje në vitin 2018 dhe 404 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Familjare pa palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, “Penale krime”, “Penale kundërvajtje”, “Seanca paraprake-kërkesa për pushimin e procedimit penal” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se nga 943 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 203⁹⁹ prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë 21.5% të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja dhe zëvendëskryetarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se është përpjekur të zhvillojë gjykimet brenda afateve të arsyeshme, por pa cenuar elementet e procesit të rregullt ligjor, në drejtim të njoftimit të rregullt të palëve, garantimin e së drejtës për tu njohur me aktet, siguruar mbrojtjen apo edhe detyrimin e gjykatës për të zhvilluar hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, me qëllim zgjidhjen e drejtë të saj. Gjithashtu,

⁹⁸Duke përfshirë edhe çështjen me numër rendor 10, në Tabelën nr.11 të vitit 2017, në kushtet kur çështja ka objekt “Kërkesë për pushimin e procedimit penale” dhe jo “Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq” sikurse pasqyrohet në të dhënat statistikore.

⁹⁹68 çështje në viti 2017, 54 çështje në viti 2018 dhe 81 në vitin 2019. Këtu nuk janë përfshirë çështjet (i) me numër rendor 26, tabela nr.2, vitit 2018, pasi në të tabelën e të dhënave statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat evidentohet që koha e përfundimit të gjykimit është pasqyruar gabimisht 2 muaj e 8 ditë, ndërkohë që çështja i është caktuar gjyqtarëve në datën 07.09.2018 dhe ka përfunduar në datën 23.10.2018, duke përfunduar për 46 ditë, pra brenda afatit standard prej 2 muaj; (ii) me numër rendor 49, tabela nr.2, vitit 2018, pasi në të tabelën e të dhënave statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat evidentohet që koha e përfundimit të gjykimit është pasqyruar gabimisht 2 muaj e 7 ditë, ndërkohë që çështja i është caktuar gjyqtarëve në datën 20.07.2018 dhe ka përfunduar në datën 10.09.2018, duke përfunduar për 52 ditë, pra brenda afatit standard prej 2 muaj

gjqtarja ka bërë prezent në disa çështje shkaqet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e shqyrtimit të tyre, të cilat nuk lidhen me veprimtarinë e gjyqtarit për administrimin e çështjes, por nga shkaqe të tjera të tilla si: koha e fazës së parë të pjesëtimit deri në fazën e dytë, koha që çështja mbetet pa veprime për shkak të pezullimit, leja vjetore e gjyqtarës, etj. Po ashtu lidhur me çështjet që i përkasin seancës paraprake (kryesisht për vitet 2018 dhe 2019), për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, shkaku i tejkalimit të afatit lidhet kryesisht me mungesën dhe zëvendësimet e herëpashershme të prokurorëve, procedurave të njoftimit për subjektet, për personin në hetim/të pandehurin dhe shpesh për palën e dëmtuar e cila në shumicën e rasteve nuk kishte një adresë të saktë në kërkesën e paraqitur nga prokuroria për pushimin e çështjes, duke vështirësuar njoftimin e tyre, etj.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 203 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtarja (*muaj gusht i vitit 2017, vitit 2018 dhe viti 2019*), apo pezullimit të gjykimit. Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtarja ka qenë me leje vjetore apo koha e pezullimit të gjykimit, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

Për kategorinë “Civile me palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 1 dhe 7¹⁰⁰ (2 çështje) i janë caktuar gjyqtarës me short në muajin korrik të vitit 2016 dhe kanë përfunduar në muajin janar dhe shkurt të vitit 2017 (201 dhe 196 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2016 (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar për 166 dhe 161 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 6 muaj (180 ditë) për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare; Po kështu edhe çështjet me numër rendor 60¹⁰¹ dhe 6¹⁰² (2 çështje) i janë caktuar gjyqtarës me short në muajin prill dhe korrik të vitit 2017 dhe kanë përfunduar në muajin nëntor 2017 dhe shkurt 2018 (194 dhe 201 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2017 (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar për 159 dhe 166 ditë, pra brenda standardit minimal kohor;
- çështjet me numër rendor 2¹⁰³ dhe 9¹⁰⁴ (2 çështje) i janë caktuar gjyqtarës me short në muajin qershor 2016 dhe korrik 2017 dhe kanë përfunduar në muajin janar 2017 dhe shkurt 2018 (219 dhe 222 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar për 184 dhe 187 ditë, pra duke e tejkaluar standardit minimal kohor 6 muaj (180 ditë) për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare vetëm me 4 dhe 7 ditë;
- çështja me numër rendor 17¹⁰⁵ (1 çështje), i është caktuar gjyqtarës me short në datën 14.09.2016 dhe ka përfunduar në datën 20.03.2017 (187 ditë). Afatit standard minimal kohor është tejkaluar vetëm me 7 ditë dhe duke pasur në

¹⁰⁰Tabela nr.1, viti 2017

¹⁰¹Tabela nr.1, viti 2017

¹⁰²Tabela nr.1, viti 2018

¹⁰³Tabela nr.1, viti 2017

¹⁰⁴Tabela nr.1, viti 2018

¹⁰⁵Tabela nr.1, viti 2017

vëmendje këtu se në kohëzgjatjen e gjykimit ka ndikuar edhe procedura e mbartjeve të dosjeve nga administrata në fund të viti, çështja do të konsiderohet se ka përfunduar brenda standardit minimal kohor.

- çështjet me numër rendor 21 dhe 38¹⁰⁶ (2 çështje) i janë caktuar gjyqtarës me short në muajin shkurt 2016 dhe janar të vitit 2015 dhe kanë përfunduar në muajin mars dhe maji të vitit 2017 (409 dhe 857 ditë). Në formularin e vetëvlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se këto çështje kanë qenë të pezulluara përkatësisht për periudhën 14.07.2016-30.03.2017 (256 ditë) dhe 30.04.2015-08.05.2017 (739 ditë). Duke zbritur kohën në të cilën çështjet kanë qenë të pezulluara, këto çështje do të kishin përfunduar për 153 dhe 118 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 6 muaj (180 ditë) për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtarë;
- çështja me numër rendor 49¹⁰⁷ (1 çështje), i është caktuar gjyqtarës me short në datën 08.03.2019 (*pas rishortimit për shkak të largimit gjyqtarit të çështjes*) dhe ka përfunduar në datën 16.10.2019 (222 ditë). Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2019 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 187 ditë, pra duke e tejkaluar standardit minimal kohor me vetëm 7 ditë;

Për kategorinë “Civile pa palë kundërshtarë”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 20, 21, 22, 25¹⁰⁸; 23, 24¹⁰⁹ dhe 29, 30, 31 32, 33¹¹⁰ (11 çështje), kanë përfunduar respektivisht 83, 75, 87, 95, 73, 72, 92, 96, 85, 91 dhe 80 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore për vitin përkatës (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtarë; Në këtë kategori çështjesh rezultojnë edhe çështjet me numër rendor 8, 31 dhe 33¹¹¹ (3 çështje), të cilat kanë përfunduar respektivisht për 61, 61 dhe 66 ditë, duke tejkaluar me vetëm 1 apo 6 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë;

Për kategorinë “Familjare me palë kundërshtarë”, rezulton se:

- çështja me numër rendor 15¹¹² (1 çështje) me objekt “Zgjidhje martesë”, është regjistruar në datën 21.12.2016 dhe ka përfunduar në datën 02.05.2017, referuar të dhënave rezulton se çështja ka përfunduar në një afat prej 132 ditë. Afatit standard minimal kohor është tejkaluar me 12 ditë dhe duke pasur në vëmendje këtu që çështja është regjistruar në fund të vitit, periudhë kjo që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata, çështja do të konsiderohet se ka përfunduar brenda standardit minimal kohor;
- çështja me numër rendor 31¹¹³ (1 çështje), i është caktuar gjyqtarës me short në muajin qershor 2017 dhe ka përfunduar në muajin tetor të po këtij viti, kjo

¹⁰⁶Tabela nr.1, viti 2017

¹⁰⁷Tabela nr.1, viti 2019

¹⁰⁸Tabela nr.2, viti 2017

¹⁰⁹Tabela nr.2, viti 2018

¹¹⁰Tabela nr.2, viti 2019

¹¹¹Tabela nr.2, viti 2018

¹¹²Tabela nr.3, viti 2017

¹¹³Tabela nr.3, viti 2017

çështje ka përfunduar për 127 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2017 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar brenda afatit 120 ditë;

- çështjet me numër rendor 4, 14, 24¹¹⁴ dhe numër rendor 10, 13¹¹⁵ (5 çështje), kanë përfunduar respektivisht për 132, 135, 122, 125 dhe 125 ditë, duke tejkaluar me vetëm 12, 15, 2 dhe 5 ditë afatin standard prej 4 muaj ose 120 ditë, ku në dy çështjet e para ka ndikuar edhe periudha e fund vitit e cila përkon me procesin e mbajtjeve të dosjeve nga administrata gjyqësore;

Për kategorinë “Familjare pa palë kundërshtarë”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 4¹¹⁶ dhe numër rendor 4¹¹⁷ (2 çështje), kanë përfunduar për 82 dhe 80 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit standard prej 2 muaj ose 60 ditë;

Për kategorinë “Penale kundërvajtje”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 14, 17¹¹⁸ dhe çështjet me numër rendor 8, 9, 10¹¹⁹ (5 çështje), i janë caktuar gjyqtarës me short në muajit qershor apo korrik dhe kanë përfunduar në muajit tetor apo nëntor të po atij viti, përkatësisht kanë përfunduar për 126, 133, 141, 157 dhe 153 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore (35 ditë), çështjet do të kishin përfunduar brenda afatit standard prej 4 muaj ose 120 ditë ose duke e tejkaluar atë me vetëm 2 ditë. Në po këtë kategori, çështja me numër rendor 8¹²⁰ (1 çështje), rezulton të ketë përfunduar për 128 ditë, duke tejkaluar afatin standard me vetëm 8 ditë. Tejkallim i cili konsiderohet i papërfillshëm për shkak se në kohëzgjatjen e kësaj çështje ka ndikuar edhe procesi i mbartjeve të dosjeve;

Për kategorinë “Penale, seancë paraprake”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 9,¹²¹ numër rendor 18, 30¹²² dhe numër rendor 7, 11, 12 dhe 14¹²³ (7 çështje) me objekt “*Kërkesë për pushimin e procedimit penal*”, kanë përfunduar për 64, 66, 62, 71, 69, 70 dhe 87 ditë, duke tejkaluar me vetëm 4, 6, 2, 11, 9, 10 dhe 7 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë. Tejkallime të cilat konsiderohet të papërfillshëm në kushtet kur në këtë afat ka ndikuar edhe procesi i mbartjeve të dosjeve;
- çështjet me numër rendor 48¹²⁴ dhe numër rendor 58, 59, 66, 67, 68¹²⁵ (6 çështje), i janë caktuar gjyqtarës me short në muajin qershor apo korrik dhe kanë përfunduar në muajit shtator apo tetor të po atij viti, përkatësisht për 79,85, 70, 87, 70 apo 81 ditë. Duke

¹¹⁴Tabela nr.3, viti 2018

¹¹⁵Tabela nr.3, viti 2019

¹¹⁶Tabela nr.4, viti 2017

¹¹⁷Tabela nr.4, viti 2018

¹¹⁸Tabela nr.9, viti 2017

¹¹⁹Tabela nr.9, viti 2018

¹²⁰Tabela nr.9, viti 2017

¹²¹Tabela nr.11, viti 2017

¹²²Tabela nr.11, viti 2018

¹²³Tabela nr.11, viti 2019

¹²⁴Tabela nr.11, viti 2018

¹²⁵Tabela nr.11, viti 2019

zbritur periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor 2 muaj ose 60 ditë.

Për kategorinë “Kërkesa penale”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 10¹²⁶ dhe 35¹²⁷ (2 çështje), i janë caktuar gjyqtarës me short në muajin korrik dhe kanë përfunduar në muajin tetor të po atij viti, përkatësisht për 90 dhe 91ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit 60 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 2 muaj ose 60 ditë; Në këtë kategori çështjesh rezultojnë edhe çështjet me numër rendor 7,¹²⁸ 1,¹²⁹ dhe 8,¹³⁰ (3 çështje), të cilat kanë përfunduar respektivisht për 62, 63 dhe 72 ditë, duke tejkaluar me vetëm 2, 3 apo 12 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë, ku në çështjen e fundit ka ndikuar edhe procesi i mbartjes së dosjeve, pasi çështja i është caktuar gjyqtarës në datën 18.12.2018 dhe ka përfunduar në darën 28.02.2019.

Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin 57 çështjet e analizuara më sipër, të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejes vjetore apo periudha e pezullimit të gjykimit, rezultojnë të përfunduara brenda afatit apo ky afat rezulton i tejkaluar me vetëm 1 deri në 7 ditë (i papërfillshëm). Bazuar në analizën e mësipërme rezulton se nga 943 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 146 prej tyre ose rreth **15 % janë gjykuar jashtë standardit** minimal kohor në fuqi, i cili sipas Metodologjisë pikëzohet me 4 pikë.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me :

- a) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 15%;
 - b) mendimin e zëvendëskryetares dhe vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
 - c) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit 2017-2019, ku rezulton se gjyqtarja ka përfunduar 1381 çështje, nga të cilat 717 çështje me palë kundërshtare;¹³¹
 - d) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore;
- pavarësisht përqindjes së mësipërme, për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me një nivel me të lartë pikëzimi, me 5 pikë.

¹²⁶Tabela nr.12, viti 2018

¹²⁷Tabela nr.12, viti 2019

¹²⁸Tabela nr.12, viti 2017

¹²⁹Tabela nr.12, viti 2018

¹³⁰Tabela nr.12, viti 2019

¹³¹Në pikën 3 shkronja “h” të “Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore”, miratuar me vendimin e KLD nr.261/2 të vitit 2010, lidhur me Standardi sasior i punës parashikohet: **h. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje, penale (krime dhe kundërvajtje penale) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare.**

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares për treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” pikëzohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategoritë e çështjeve. Konkretisht:

- i. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 205 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 30 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 105 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “Familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 55.5 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve “Tregtare me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 27 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 124 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- vii. Në kategorinë e çështjeve “Penale-krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 65 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- viii. Në kategorinë e çështjeve “Penale-kundërvajtje”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 85 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- ix. Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 11 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- x. Në kategorinë e çështjeve “Seancë paraprake-kërkesë për pushimin e procedimit penal”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 53 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;

- xi. Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 44,5 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se në analizë të të dhënave statistikore për të gjitha kategoritë e çështjeve koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër ose e barabartë me standardin, nëse do të konsiderohen në këtë përlllogaritje çështjet që kanë qenë të pezulluara, janë kthyer për hetime, janë marrë nga gjyqtarët e tjerë pas largimit të tyre nga detyra/gjykata, etj., pa përfshirë shkaqet e kohëzgjatjes së çdo çështjeje në mënyrë specifike e cila është diktuar nga nevoja për të respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor, posaçërisht njoftimin e rregullt të palëve dhe garantimin e pjesëmarrjes dhe të drejtave të tyre gjatë procesit, si dhe nevojën për zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm më e shkurtër se ky afat për 10 nga 11 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për një nga kategoritë e çështjeve “*Civile e përgjithshme me palë kundërshtarë*”, duke u tejkalluar ky afat 22 ditë. Bazuar në të njëjtat argumente si për treguesin e “Plotësimit të standardeve minimale kohore”, si dhe duke vlerësuar kategorinë e çështjeve për të cilat ky standard rezulton i tejkalluar, vlerësoj se tejkallimi me 22 ditë është i papërfillshme për ngarkesën e gjyqtarës dhe natyrën e standardeve orientuese (jo detyruese), për këtë tregues gjyqtarja, bazuar në analizën logjike të të dhënave statistikore, pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1381 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1323 çështje) brenda vitit kalendarik, është **104%**.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe zëvendëskryetarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, përqindjes së mësipërme (+99%) i përkon pikëzimi maksimal me 10 pikë.

KONKLuzioni

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me nivelin maksimal 10 pikë, pasi rendimenti rezulton në masën 104%.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- (i) Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit është 11 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (ii) Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit është 8 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (iii) Për çështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit është 10 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (iv) Për çështje të kategorisë “Familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit është 10 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (v) Për çështje të kategorisë “Tregtare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit është 7 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (vi) Për çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsyetimit është 11 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (vii) Për çështje të kategorisë “Penale-krime”, koha mesatare e arsyetimit është 9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale;
- (viii) Për çështje të kategorisë “Penale-kundërvajtje”, koha mesatare e arsyetimit është 9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale;
- (ix) Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton, sipas objekti, si vijon:
 - a. kërkesa me objekt “Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi”,

- koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 5 ditë, **e barabartë** me afatin procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale;
- b. kërkesa me objekt “Caktim mase sigurimi”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 2 ditë, **më e gjatë** se afati procedural 24 orë, sipas parashikimeve të nenit 244/1 të K.Pr.Penale;
 - c. kërkesa me objekt “Verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit dhe shqyrtim informacioni”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 2 ditë, **e barabartë** me afatin procedural 48 orë, sipas parashikimeve të nenit 248 të K.Pr.Penale;
 - d. kërkesa me objekt “Zëvendësim/revokim mase sigurimi”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 8 ditë, **më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale;
 - e. kërkesa me objekt “Shuarje mase sigurimi”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 4 ditë, **më e gjatë** se afati procedural 48 orë, sipas parashikimeve të neneve 261/3 dhe 248/2 të K.Pr.Penale;
 - f. kërkesa me objekt “Lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 0 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 24 orë, sipas parashikimeve të nenit 222 të K.Pr.Penale;
 - g. kërkesa me objekt “Kontrolli vendeve”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 0 ditë, **i barabartë me** afatin procedural i parashikuar nga nenin 202/a i K.Pr.Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar;
 - h. kërkesa të fazës së hetimit paraprak për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat të posaçëm për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 6 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë sipas parashikimeve të nenit 382/2 të K.Pr.Penale;
- (x) Për çështje të kategorisë “Seancë paraprake”, koha mesatare e arsyetimit është:
- a. në çështjet me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 7 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K.Pr.Penale;
 - b. në çështjet me objekt “Kërkesë për pushim procedimi”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale;
- (xi) Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”, koha mesatare e arsyetimit është:
- a. në kërkesat me objekt “Përrjashtim gjyqtari”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 5 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 22 i K.Pr.Penale;
 - b. në kërkesat me objekt “Shtyrje e ekzekutimit të vendimit”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 11 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 476 i K.Pr.Penale.
 - c. në kërkesat të fazës të ekzekutimit për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat të posaçëm për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 10 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë sipas parashikimeve të nenit 382/2 të K.Pr.Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe zëvendëskryetarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke argumentuar se referuar

statistikave të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat rezulton se të gjitha kategoritë e çështjeve koha mesatare e arsyetimit gjyqësor është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural. Nëse ka pasur ndonjë rast për dorëzimin në sekretari me vonesë kjo ka ndodhur për shkaqe të pavarura prej saj, si: (i) data e depozitimit nuk i korrespondon datës reale të arsyetimit të vendimit. Data e dorëzimit fizik në disa raste ka qenë më e vonë se data e arsyetimit të vendimit. (ii) natyra komplekse e çështjes apo numri të madh të palëve ose si rrjedhojë e pretendimeve dhe prapësimeve komplekse të tyre, të cilat kanë pasur nevojë të arsyetohen më gjerësisht.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se:

- tejkalmimi i afatit procedural për nën kategorinë e çështjeve me objekt *“çaktim mase sigurimi”* dhe *“Zëvendësim/revokim mase sigurimi”* me vetëm 1 dhe 3 ditë, përbën një tregues të papërfillshëm duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor të cilat mund të kenë ndikuar në afatin e dorëzimit të dosjes, duke konsideruar që ky afat i përket vetëm një pjesë të çështjeve të kategorisë *“Penale të hetimit paraprak”* ndërkohë që për pjesën tjetër që përbën këtë kategori koha mesatare e arsyetimit rezulton më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural;
- tejkalmimi i afatit procedural 5 ditor, për çështjet me objekt *“Shtyrje e ekzekutimit të vendimit”*, me 11 ditë dhe tejkalmimi i afatit procedural 2 ditor, për çështjet me objekt *“Përjashtim gjyqtari”*, me 3 ditë, duhen vlerësuar duke konsideruar faktin që këto afate i përkasin vetëm një pjesë të çështjeve të kategorisë *“Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”* ndërkohë që për pjesën tjetër që përbën këtë kategori koha mesatare e arsyetimit rezulton më e shkurtër se afati procedural.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si *“Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”*, pasi vetëm për katër nënkategori çështjesh rezulton që afati procedural të jetë tejkalmuar me 1, 3 dhe 11 ditë pasur në konsideratë numrin e vendimeve të gjyqtarës për arsyetim, e bën këtë afat të cenuar të papërfillshëm për tu marrë në konsideratë, ndërkohë që për të gjitha kategoritë e tjera afati i arsyetimit rezulton më i shkurtër dhe në një pjesë të tyre i barabartë me afatin procedural.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh,¹³² duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 3.8 seanca;
- (ii) për kategorinë “Familjare me palë kundërshtare” është 3 seanca;
- (iii) për kategorinë “Penale themeli” është 3 seanca;
- (iv) për kategorinë “Penale seancë paraprake” është 4 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton të jetë **3.6 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja ka kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile, si dhe duke përcaktuar provat që do të shqyrtohen në gjykim apo sipas K.Pr.Penale në çështjet penale, duke urdhëruar kryerjen e njoftimeve për palët dhe marrjen e masave për të siguruar prezencën apo shoqërimin e të pandehurve.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: *kalimin e çështjes në seancë gjyqësore; për t'i dhënë kohë palës paditëse për rregullimin e ndërgjyqësisë; me qëllim njoftimit e të paditurit për t'u paraqitur personalisht; me qëllim realizimin e aktit të ekspertimit; për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim nga palët; për t'i dhënë mundësi të pandehurit të sigurojë të drejtën e mbrojtjes; për të siguruar pjesëmarrjen e prokurorit në seancë; me qëllim plotësimit e*

¹³²Referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, rezulton se nuk është gjeneruar numri i seancave gjyqësore për të gjitha çështjet. Për pasojë, referuar Metodologjisë së Pikëzimit”, numri mesatar i seancave gjyqësore do të përllogaritet duke iu referuar 19 (nëntëmbëdhjetë) çështjeve me palë kundërshtare, të përzgjedhura me short për vlerësim

hetimeve paraprahe sipas veprimeve konkrete hetimore të përcaktuara në vendimin e gjykatës, etj.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues, përgjithësisht, rezultojnë që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë të afërt dhe të jenë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesë të gjykimit. Konstatohet se në rastet kur palët apo përfaqësuesit e tyre janë bërë shkak për zvarritjen e gjykimit, gjyqtarja u ka bërë vërejtje, për të mos u përsëritur më e njëjta situatë.

Caktimi i seancës së parë gjyqësore në ato raste kur parashikohet një detyrim ligjor për t'u respektuar (si afat maksimal), rezultojnë që gjyqtarja e ka respektuar afatin në të gjitha rastet (*në tre çështjet e kategorisë seancë paraprahe, gjyqtarja për caktimin e seancës së parë gjyqësore ka respektuar afatin 5 ditor të parashikuar në nenin 329/b apo në nenin 332/1 të K.Pr.Penale, të ndryshuar*). Përgjithësisht, rezultojnë se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 10-20 ditësh nga njëra-tjetra në çështjet civile/familjare dhe deri në 14 ditë, konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale, në çështjet penale. Vetëm në disa raste konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht, apo në fund të vitit, periudhë që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezultojnë se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.6 seanca (ky numër tejkalohet vetëm me 0,6%) dhe në kushtet kur gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, aftësia e gjyqtarës vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, në çështjet civile gjyqtarja është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore ose pajtimi në çështjet familjare (*neni 158/b i K.Pr.Civile dhe neni 132 i K. Familjes*) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (*neni 158/ç i K.Pr.Civile*). Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjyqtarja ka vënë dosjen në lëvizje brenda ditës ose brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, në nenin 329/b për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt pushimin e procedimit penal, në nenet 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale, për çështjet e kategorisë penale themeli.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja jo vetëm ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën, por ka treguar edhe kujdes maksimal në marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimit të zhvilluar (*nenet 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), ose sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale*).

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativitetin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa që shkojnë deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa

diferenca kohore. Megjithatë konstatohet edhe një numër seancash (6 seanca)¹³³ të filluara me më shumë se 20 minuta deri në 45 minuta vonesë nga ora e planifikuar. Në tërësi pavarësisht fillimit me vonesë të disa prej seancave gjyqësore, të cilat rezultojnë në një përqindje të vogël në raport me seancat e analizuar (8.7% e seancave rezultojnë të filluara me vonesë) nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes. Shkaku i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relatimit të gjyqtarës lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, për shkak të shoqërimit me vonesë të të arrestuarit nga toga e shoqërimi apo mungesa e sallave të lira. Distancat kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkaku për të cilin seanca është shtyrë.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, në përgjithësi mbajtur me regjistrim audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Shkak i mos zhvillimit të të gjitha seancave gjyqësore me sistemin audio ka qenë për arsye administrative dhe funksionaliteti në gjykatën pranë se cilës ka ushtruar funksionin gjyqtarja në periudhën e vlerësimit (për shkak të pamundësisë së zhvillimit të seancës gjyqësore në sallë). Pavarësisht këtij shkak, seancat të cilat nuk janë zhvilluar me sistemin audio janë dokumentuar me procesverbal gjyqësor me shkrim të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryera

¹³³Shkaku relatohet nga gjyqtarja përpara fillimit të seancës gjyqësore dhe të pasqyruar në procesverbalin e seancës. Shih dosjet që i përket vendimit nr.108, datë 23.09.2019, nr.135, datë 14.02.2018, nr.260, datë 26.03.2018, nr.553, datë 20.12.2018 dhe nr.314, datë 18.09.2019

nga gjyqtarja gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të shfrytëzueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*kërkesëpadi, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, komunikimet shkresore me të tretët, urdhri/vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore përfundimtare*).

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit vitet 2017-2019, ndaj gjyqtarës rezulton të jenë paraqitur 4 (katër)¹³⁴ ankesa dhe 1 (një) informacioni nga kryetari i gjykatës, për të cilat, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.1001/3 prot., datë 29.12.2020, nr. 995/2 prot, datë 24.06.2021, nr.254/2 prot., datë 12.07.2021 dhe nr.946/1 prot., datë 13.04.2023 ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

I- Ankesa e shtetasit P.D., depozituar në KLGJ me nr.1638 prot, datë 18.03.2019, regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr.1001 prot, datë 09.06.2020, konsiston në pretendime lidhur me vendimmarrje të padrejtë, në kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, të përfunduar me vendimi nr.474, datë 03.05.2012. Me vendimin nr.1001/3 prot., datë 29.12.2020 ILD ka vendosur arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së ankuesit P.D., ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, duke arsyetuar se ankesa nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë, referuar nenit 120, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar.

¹³⁴Në informacionin e dërguar nga ILD me shkresën nr.2323/1 prot., datë 28.05.2021 rezulton se për periudhën e vlerësimit për gjyqtaren janë paraqitur 11 (njëmbëdhjetë) ankesa, ndërkohë referuar vendimeve të dërguara rezulton se 7 (shtatë) prej ankesave nuk ngre pretendime ndaj veprimtarisë së gjyqtarës {...}, konkretisht ankesat e paraqitura nga ankuesi P.D. me nr. 4576 port., datë 18.09.2019, nr.255/1 prot., datë 11.06.2021, nr.1572 prot., datë 04.03.2019 dhe nr.2314 prot., datë 19.04.2019, por ankesa është paraqitur për gjyqtarë tjetër. Po kështu, ankesat e paraqitura nga shtetasi A.M., me nr.951 prot., datë 08.06.2020, nr.1273/2 prot., datë 16.09.2020 dhe me nr.1946 prot., datë 07.04.2021, përmbajnë pretendime lidhur me veprimtarinë e gjyqtarëve të gjykatës së apelit dhe jo për gjyqtaren {...}

II- Ankesa e shtetasit J.S., depozituar pranë Zyrës së ILD, regjistruar me nr.3258, datë 13.11.2018 konsiston në pretendimet për zvarritje të gjykimit, lidhur me çështjen civile me nr.21286/001238-63-2018 (1170/216) regjistri, datë 06.09.2018, në të cilën ankuesi ka qenë në cilësinë e palës paditëse. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, me vendimin nr.995/2 prot., datë 24.06.2021, ILD ka vendosur për arkivimin e ankesës për shkak ankesa nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenin 120/1 pika “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016.

III- Ankesë e shtetasja Th.A., depozituar në ILD me nr. 512 prot., datë 25.01.2017. Përmes kësaj ankese, ankuesi ngre pretendime për veprimtarinë gjyqtares të gjyqtares {...} gjatë shqyrtimit të çështjes civile të përfunduar me nr.415, datë 31.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Pas verifikimit të ankesës ILD ka konkluduar se pretendimi i ankuesit për zvarritje të procesit gjyqësor nga magjistarja {...} nuk qëndron. Po kështu, në lidhje me pretendimin se magjistarja ndryshe është shprehur për shpenzimet gjyqësore gjatë shpalljes së vendimit dhe ndryshe është shkruar në dispozitivin e vendimit të arsyetuar, nga krahasimi i regjistrimit të seancës gjyqësore me dispozitivin e vendimit gjyqësore, rezultoi përputhshmëri e plotë e tyre. Rrjedhimisht, me vendimin nr. 254/2 prot., datë 12.07.2021 ILD ka disponuar “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. Th.A.”.

IV- Informacioni periodik i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat lidhur me seancat gjyqësore të filluara me vonesë. Me vendimin datë 05.07.2018 “Për verifikimin e informacionit periodik të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, mbi fillimin me vonesë të seancave gjyqësore në muajin prill 2018” ish-IKLD, ka vendosur marrjen e të dhënave shtesë mbi rastet e vonesave të 10 seancave gjyqësore, duke kërkuar të përcaktohen emrat e gjyqtarëve, çështjet gjyqësore, kopje të procesverbaleve, si dhe kalendari i gjykimeve në ditët kur seancat kanë filluar me vonesë, me qëllim që të vijohet me hetimin disiplinor ndaj gjyqtarëve nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer. Nga informacioni shtesë i dërguar nga gjykata me shkresën nr.1082/1 prot., datë 26.07.2018, rezulton se gjyqtarja {...} ka filluar me vonesë seancën gjyqësore të datës 23.04.2018, e cila ka filluar në orën 11:38, nga ora 11:00 në të cilën ishte planifikuar. Shkak për fillimin me vonesë është bërë angazhimi i gjyqtares në proces të tjera penale. Praktika i është përcjellë për trajtim ILD-së, ku është regjistruar me nr.895 prot., datë 16.02.2021. Pas verifikimit të praktikës ILD me vendimin nr.946/1 prot., datë 13.04.2023, ka vendosur arkivimin e informacionit periodik të kryetarit të gjykatës mbështetur në nenin 122, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

V- Në ankesat e shtetasit A.J., depozituar në KLGJ me nr. 4080 prot, datë 29.07.2019 dhe nr.4665 prot., datë 25.09.2019, regjistruar pranë Zyrës së ILD respektivisht me nr.1272 prot, datë 16.06.2020 dhe nr.1317 prot., datë 24.06.2020 ngrihen pretendime për veprimtarinë e disa magjistratëve, ndër ta edhe për gjyqtaren {...}. Lidhur me gjyqtaren {...} ankuesi ngre pretendime për njëanshmëri gjatë shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ILD me vendimin nr.1169 prot., datë 13.04.2023 ka vlerësuar se pretendimet zgjidhen mbi bazën e

apelimit gjyqësor në rast të ushtrimit të ankimit të vendimit të dhënë dhe për rrjedhojë ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 120, pika 1, shkronja “ç”, “d”, dhe “dh” të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dh prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtarës subjekt vlerësimi.

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetarja e gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarës në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, etika e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarës

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD paraqitur 4 (katër) ankesa dhe 1 (një) informacioni nga kryetari i gjykatës, të trajtuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.1001/3 prot., datë 29.12.2020, nr. 995/2 prot, datë 24.06.2021, nr.254/2 prot., datë 12.07.2021 dhe nr.946/1 prot., datë 13.04.2023, në të cilat është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtarës {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 2807/1 prot., datë 09.07.2021, rezulton se: “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se për gjyqtaren {...}: a) Deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; c) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave”.

Gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë. I njëjti vlerësim është dhënë edhe nga zëvendëskryetarja e gjykatës.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indice që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtares, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtares.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetarja, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, janë paraqitur 9 (nëntë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës, nga të cilat vetëm 1 (një) kërkesë është pranuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 36 (tridhjetë e gjashtë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 34 (tridhjetë e katër) janë pranuar.

KONKLUZIONI

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës (vetëm 1 kërkesë për një periudhë 3 vjeçare), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, marrjen e provave nga të tretët, etj.*) është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetarja e gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e

konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës lidhur me këtë tregues, vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe zëvendëskryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe zëvendëskryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses

në 42 (dyzet e dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 60.5 ditë trajnimi.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në aktivitetet profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 42 aktivitete të zhvilluara për 60.5 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e gjyqtares {...} në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses apo trajnueses. Po ashtu, nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në udhëheqjen e kandidatëve për magistratë gjatë periudhës së stazhit profesional, por njëkohësisht nuk rezultojnë të dhëna për zhvillimin e këtij

aktiviteti pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ku ajo ka ushtruar funksionin në periudhën e vlerësimit.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese pranë Shkollës së Magjistraturës apo të ketë pasur mundësi të udhëheqë kandidatë për magjistratë gjatë stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, duke qenë se nuk rezulton angazhimi i gjyqtares, ajo pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019), në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna konkrete në drejtim të tij.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarës në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 (zero) pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtarës, duke e pikëzuar me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësi të profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësi organizative të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësi personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave

të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë

					Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë

	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Më e shkurtër ose e barabartë	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural

		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve		për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarës: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë

		kryetarit			Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme,	1. Informacioni i marrë nga	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të

gjqtares	nderi dhe dinjiteti	ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI			gjqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia

A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Dokumente të dorëzuara	5-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarës: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4

tjera		nga gjyqtarja			
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtares	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		391			
IVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES		Shkëlqyeshëm			

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

